



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
Zyra e Kryeministrit Ured Premijera Office of the Primeminister

**AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË**  
**AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO**  
**FOOD AND VETERINARY AGENCY**

**Udhëzues i përgjithshëm mbi importin në BE-së  
dhe rregullat e tranzitit për kafshë të gjalla dhe  
produkte shtazore nga vendete e treta**

# Drejtoria D – Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve

17 Korrik 2007

## **TABELA E PËRMBAJTJEVE**

HYRJE.....	5
1. PRINCIPET E PËRGJITHSHME.....	5
2. SITUATA E SHËNDETIT TË KAFSHËVE .....	7
3. KONTROLLAT E MBETJEVE, NDOTËSVE DHE ADITIVËVE.....	9
4. KONTROLLI MICROBIOLOGJIK.....	9
5. STANDARDET E SIGURISË SË USHQIMIT NË FABRIKAT E PROCESIMIT.....	10
6. KONTROLLAT E IMPORTIT NË LIDHJE ME BSE.....	10
7. STANDARDET E AUTORITETIT NACIONAL.....	11
8. PROCEDURA E MIRATIMIT TË VENDIT/SHTETIT.....	12
9. PROVIZIONET PËR MIRËQENIEN E KAFSHËVE.....	14
10. QERTIFIKATA E SHËNDETIT.....	14
11. INSPEKTIMI KUFITAR NË HYRJE TË BE-SË.....	15
12. KËRKESAT E TRANSPORTIT.....	16
13. IMPORTET PERSONALE.....	16
14. KORNIZA E RE E LËGJISLACIONIT.....	16
15. KONTAKTI FILLESTAR.....	17
16. LEGJISDLACIONI RELEVANT I BE-së.....	18
16.1. Detajet e kontaktimit zyrtar .....	18
Këshilla praktike.....	18
16.2. Legjislacioni i përgjithshëm në fuqi.....	20
16.3. Legjislacioni për mirëqenien e kafshëve.....	23
16.4. Materialet në kontakt me artikujt ushqimorë.....	23

16.5. Kontrollat e mbetjeve dhe ndotësve.....	25
16.6. Lista e vendeve të treta të miratuara dhe kërkesat për qertifikim .....	26
16.7. Listat dhe listat provizionale të ndërmarjeve të miratuara të vendeve të treta: produktet embrionale.....	29
16.8. Listat dhe listat provizionale të ndërmarjeve të miratuara të vendeve të treta: produktet për konsum të njerëzve.....	29
16.9. Legjislacioni në lidhje me kafshët shoqëruese .....	30
16.10. Legjislacioni në lidhje me procedurat e inspektimit në pika kufitare IPK.....	31
16.11. Legjislacioni Zooteknik.....	32
17. PYETËSORI PARA-MISIONAL.....	33
1. INFORMATAT E PËRGJITHSHME.....	34
1.1. Emri i vendit/shtetit .....	34
1.2. Çështjet gjeografike.....	34
2. POPULLATA E BAGËTISË.....	34
3. LEGJISLACIONI.....	34
4. SITUATA E SHËNDETIT TË KAFSHËVE.....	35
4.1. Legjislacioni për shëndetin e kafshëve.....	35
4.2. Kontrollat rutinore të shëndetit të kafshëve.....	35
4.3. Njohtimi i sëmundjeve .....	35
4.4. Epidemitë/shpërthimi i sëmundjeve (lista e vjetër e sëmundjeve OïE A).....	36
4.5. Vaksinimi.....	36
4.6. verifikimet para-eksportit .....	36
5. SISTEMET E KONTROLLIT TË AUTORITETIT KOMPETENT .....	36
5.1. Strukturat e menagjmentit.....	36
5.2. Pavarësia e shërbimeve zyrtare.....	37
5.3. Burimet.....	37
5.4. Personeli.....	38
5.5. Rekrutimi & trainimi .....	38
5.6. Fuqitë legale/zbatimit .....	39

5.7. Prioritizimi i kontrollave (programet rutinore).....	39
5.8. Dokumentimi i kontrollave (programet rutinore).....	39
5.9. Shërbimi laboratorik.....	39
5.10. Kontrollat e importit.....	40
5.11. Njohtimi i sëmundjeve të kafshëve & sistemet e kontrollit.....	40
5.12. Kontrollat kimike të sigurisë së ushqimit .....	40
5.13. Kontrollat mikrobiologjike të sigurisë së ushqimit .....	41
5.14. Kontrollat e mbetjeve .....	41
5.15. Kontrollat mbi përdorimin dhe distribuimin e barnave veterinare .....	41
6. REGJISTRIMI I FERMAVE .....	42
7. IDENTIFIKIMI I KAFSHËVE.....	42
8. KONTROLLAT E LËVIZJEVE.....	42
9. QERTIFIKIMI.....	43
10. KONTROLLAT E IMPORTIT.....	43
11. FUNKSIONET E LABORATORIT.....	44
12. KONTROLLAT E ZOONOZAVE DHE HELMIMIT ME USHQIM.....	44
13. STANDARDET E SIGURISË SË USHQIMIT (NË RAPORT ME SEKTORËT PËR TË CILAT MIRATIMI PËR EKSPORT ËSHTË KËRKUAR, NËSE ËSHTË E ZBATUESHME).....	45
13.1. Detajet e prodhimit.....	45
13.2. Hapësirat e procesimit të të gjitha ushqimeve.....	45
13.3. Mishi i kuq, prodhimi i mishit të gjahut dhe lepujve në ferma.....	46
13.4. Mishi i gjahut të egër.....	47
13.5. Prodhimet e mishit.....	48

## **HYRJE**

Legjislacioni i detajuar i BE-së në fushën e veterinars parashton kushtet që i adresohen importimit të kafshëve të gjalla dhe prodhimeve me origjinë shtazore nga vendet e treta. Përgjegjësia për këtë fushë shtrihet brenda sferës së Drejtorisë – Përgjithshme për Shëndet & Mbrojtje të Konsumatorit /Health & Consumer Protection

Directorate-General (DG SANCO). Legjislacioni i Bashkësisë Evropiane në këtë fushë është plotësisht i harmonizuar (veçmas nga qertifikatat e caktuara të importit të cilat ende nuk janë themeluar) dhe legjislacioni kryesor relevant është në listë në Aneks. BE mban kujdes të veçantë për të siguruar se ky legjislacion është plotësisht në harmoni me obligimet e saj ndërkombëtare dhe në veçanti me kërkesat e Marrëveshjes Sanitare dhe Fitosanitare të Organizatës Botërore të Tregtisë.

Ky legjislacion imponon një varg kërkesash të shëndetësisë dhe mbikqyrjes, të dizajnuara për sigurimin se kafshët e importuara dhe produktet plotësojnë standardet të paktën në mënyrë ekvivalente me ato që kërkohen për prodhim të tyre, dhe tregtim në mes të Shteteve Anëtare. Në disa fusha, ku nuk ekziston ende ndonjë qertifikim i harmonizuar, siq është theksuar në Aneks të këtyre vërejtjeve të udhëzimit, vendet e treta duhet të kontaktojnë autoritetet e Shtetit Anëtarë për të marrë informata për kushtet e importit nacional.

Ky dokument ofron udhëzime në rradhë të parë për autoritetet nacionale në vendet e treta që janë të interesuar në eksport të kafshëve të gjalla dhe/ose produkteve të tyre në bashkësinë Evropiane.

Palët e interesuara duhet gjithmonë të kontaktojnë Komisionin Evropian (për detajet e kontaktimit shih Seksionin 14) për të verifikuar nëse kanë ndodhur ndryshime në procedurat e përshkruara në këtë dokument, dhe për udhëzime më të detajuara në lidhje me sektorët e caktuar të prodhimit. Është paraparë gjithashtu që palët e tjera të interesuara mund të përfitojnë nga informatat e ofruara në këtë udhëzim. Në rast të tillë ata këshillohen të kontaktojnë autoritet e tyre nacionale nëse dëshirojnë asistim të mëtejshëm, informata dhe/ose inicojnë procedurat e miratimit në lidhje me importimet në Komisionin Evropian.

Duhet gjithashtu të vërehet se, në shikim të një spektri shumë të gjerë të produkteve të mbuluara nga këto udhëzime, disa elemente nuk i takojnë të gjitha importeve. Disa nga çështjet kyçe në lidhje me importet, veçanërisht nga pikëvështrimi i shëndetit publik janë theksuar në një udhëzim tjetër i cili është në dispozicion në Internet.

## **1. PRINCIPET E PËRGJITHSHME**

Një përshkrim i detajuar i sekuencës së hapave dhe veprimeve individuale që duhet të ndiqen kur një vend i tretë kërkon miratim është dhënë në Seksionin 7. Në raste të

shumta, një inspektim në vend të ngjarjes nga Drejtoria FVO e DG SANCO (Zyra e Ushqimit dhe Veterinës (ZUV) kërkohet para se miratimi të merret parasysh. Kjo është e hartuar për të vlerësuar nëse situata e shëndetit të kafshëve dhe ai publik, shërbimet zyrtare, provizionet ligjore, sistemet e kontrollit dhe sistemet e prodhimit etj., i plotësojnë kërkesat e BE-së.

Kur listat e vendeve të treta të autorizuar ose pjesët e vendeve të treta për qëllime të shëndetit të kafshëve hartohen ose ndryshohen, vëmendje e posaçme i kushtohet:

(1) statusit shëndetësor të bagëtisë, kafshëve tjera shtëpiake dhe kafshëve të egra në vendin e tretë, me konsideratë të posaqme në sëmundjet e kafshëve ekzotike dhe cilit do aspekt të shëndetit në përgjithësi dhe situatës ambientale në vendin e tretë i cili mund të paraqesë rrezik për shëndet dhe stauts ambiental të Komunitetit;

1 [http://ec.europa.eu/food/international/trade/interpretation\\_imports.pdf](http://ec.europa.eu/food/international/trade/interpretation_imports.pdf)

(2) legjislacionit të vendit të tretë mbi kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore;

(3) organizimit të autoritetit kompetent veterinar dhe shërimeve të tij të inspektimit; fuqive të këtyre shërbimeve, mbikqyrjeve që ata i nënshtrohen, dhe mënyrave të asgjësimit të tyre, përfshirë personelin dhe kapacitetin laboratorik, për të zbatuar legjislacionin në mënyrë efektive;

(4) garancive që mund të jap autoriteti kompetent veterinar i vendit të tretë në lidhje me plotësimin ose ekvivalencën me kushtet relevante të shëndetit të kafshëve të zbatueshme në Komunitet;

(5) se a është vendi i tretë anëtar i Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve (OiE) dhe rregullsisë dhe shpejtësisë së informatës të mbledhur nga vendi i tretë në lidhje me ekzistimin e sëmundjeve infektive ose ngjitëse në territorin e tij, posaqërisht të atyre sëmundjeve të vëna në listë nga OiE;

(6) garancioneve të dhëna nga vendi i tretë për të informuar drejtpërsëdrejti Komisionin dhe Shtetet Anëtare:

(a) brenda 24 orëve të konfirmimit të paraqitjes së ndonjë sëmundjeje të madhe serioze që brengos dhe për çfarëdo ndryshimi në politikat e vaksinimit në lidhje me atë sëmundje;

(b) brenda një periudhe të përshtatshme, për çfarëdo ndryshime të propozuara në rregullat nacionale të shëndetit në lidhje me llojin e kafshëve të gjalla, posaqërisht sa i përket importit;

(c) në intervalet e rregullta, për statusin shëndetësor të kafshëve në territorin e tyre;

(7) çfarëdo përvoje të importve të mëhershme nga vendi i tretë dhe rezultatet e kontrollave të kryera të cilit do import;

(8) rezultatet e inspektimeve dhe/ose auditimeve të Komunitetit të kryera në vendin e tretë, posqërisht rezultatet e vlerësimit të autoriteteve kompetente ose, kur Komisioni kërkon ashtu, raportimi i dorëzuar nga autoritetet kompetente mbi inspektimet të cilat ata i kanë kryer;

(9) rregullat e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve infektive apo ngjitëse që janë në fuqi në vendin e tretë dhe implementimi i tyre, përfshirë rregullat mbi importimin nga vendet e tjera të treta.

Kur listat e vendeve të treta të autorizuar ose pjesë të vendeve të treta për qëllime të shëndetit publik hartohen ose ndryshohen, krahas shumicës së provizioneve të sipërpërmendura, të ndryshuara sipas zbatueshmërisë në fushën e shëndetit publik, vëmendje e veçantë i kushtohet:

(1) trainimit të personelit për performimin e kontrollave zyrtare;

(2) burimeve përfshirë ndihmesave diagnostifikuese që janë në dispozicion të autoriteteve kompetente;

(3) ekzistimit dhe funksionimit të procedurave të dokumentuara të kontrollit dhe sistemeve të kontrollave të bazuara në prioritet;

(4) nivelit dhe funksionimit të kontrollave mbi imoportin e kafshëve dhe produkteve të tyre;

(5) garancive që mund t'i jap vendi i tretë në lidhje me përputhjen, ose ekvivalencën, me kërkesat e Komunitetit

(6) kushteve të higjienës së prodhimit, fabrikimit, procesimit, magazinimit dhe dërgimit që aktualisht zbatohen për prodhimet me origjinë shtazore të destinuar për Komunitet;

(7) çfarëdo përvoje të marketimit të prodhimit nga vendi i tretë dhe rezultateve të cilit do importi të kryer;

(8) rezultateve të kontrollave të Komunitetit të kryera në vendin e tretë, posqërisht rezultateve të vlerësimit të autoriteteve kompetente, dhe veprimit që autoritetet kompetente kanë marrë në dritë të ndonjë rekomandimi që u është adresuar atyre pas kontrollit të Komunitetit;

(9) ekzistimit, implementimit dhe komunikimit të programeve të miratuara të kontrollit të zoonozave;

(10) përdorimit të produkteve mjekësore veterinarë, përfshirë rregullat për ndalimin e tyre ose autorizimin, shpërndarjen e tyre, vendosjen e tyre në treg dhe rregullave që mbulojnë administrimin dhe inspektimin;

(11) përgaditjes dhe përdorimit të artikujve ushqimorë, përfshirë procedurat për përdorimin e aditivëve dhe përgaditjen dhe përdorimin e ushqimit të kafshëve dhe produkteve finale;

(12) ekzistimit, implementimit dhe komunikimit të programeve të miratuara të kontrollit të mbetjeve.

Këto lista të hartuara për qëllime të shëndetit të kafshëve dhe shëndetit publik mund të jenë por jo domosdoshmërisht të kombinuara me njëra tjetrën. Në raport me ndërmarjet e origjinës së prodhimit shtazor autoritetet nacionale duhet gjithashtu të garantojnë se:

(1) kushtet e zbatuara në ndërmarjet prej të cilave ushqimi i kafshëve dhe ushqimi mund të importohet në Komunitet përputhen me ose janë ekuivalente me kërkesat e ligjit të Komunitetit mbi ushqimin e kafshëve dhe ushqimin;

(2) një listë e ndërmarjeve të tilla është hartuar dhe mabhet e azhurnuar;

(3) lista e ndërmarjeve dhe verzionet e saj të azhurnuara i komunikohen Komisionit pa vonesë;

(4) ndërmarjet i nështrohen kontrollave të rregullta dhe efektive nga autoriteti kompetent i vendit të tretë.

Për shumicën e komoditeteve, ku është pranuar kërkesa për miratim nga Komisioni, një pyetësor paraprak, në lidhje me kafshët/produktet në fjalë, do të dërgohet te autoritetet nacionale. Kjo është disajnuar për të vlerësuar nëse kërkesat e Komunitetit mund të kënaqen dhe të mbledhen informatat para ndonjë inspektimi të mundshëm në vend nga ZUV.

Për informata të mëtejme një model i këtij pyetësori është përfshirë, në pikën 16.

Kur informata e ofruara nga autoritetet nacionale konsiderohet e kënaqshme, dhe inspektimi i ZUV çon drejt një rekomandimi të dëshirueshëm, Komisioni do të adaptojë legjislacionin e nevojshëm për të dhënë miratim për importe pas marrjes së një mendimi të favorshëm të Komitetit Qëndrues mbi Zingjirin e Ushqimit dhe Shëndetin e Kafshëve



(që përbëhet nga përfaqësuesit e Shefave të Zyreve veterinare të Shteteve Anëtare). Miratimet mund të mbulojnë tërë ose pjesë të vendit të tretë, duke reflektuar situatën e shëndetit të kafshëve dhe atë publik dhe natyrën e kafshëve/prodhimeve për të cilat është kërkuar miratimi.

## **2. SITUATA E SHËNDETIT TË KAFSHËVE**

Vendi i tretë duhet të jetë anëtare e OiE dhe të ketë të vendosura sistemet për detektim të shpejtë, raportim dhe konfirmim të sëmundjeve nga lista e OiE -së. Ai gjithashtu duhet të jap një premtim formal që të njoftojë Komisionin Evropian për epideminë/ shpërthimin e ndonjë sëmundje serioze brenda 24 orëve të konfirmimit të çfarëdo ndrysdhimi në ppolitikën e vaksinimit në lidhje me një sëmundje të tillë.

Vendi i tretë duhet ose të ketë hapësirat e veta laboratorike të cilat do të mundësojnë këtë detektim dhe konfirmim të zë vend,ose të ketë të vendosura marrëveshje formale me laboratore të përshtatshme në vendet e tjera. Labororet e angazhuara në kontrollat zyrtare nevojitet të jenë të akredituara që nga 1 janari 2006. Autoriteti kompetent mund të emëroj një laborator të paakredituar që të kryej kontrollat zyrtare me kusht që skemat e kontrollit të cilësisë janë të vendosura dhe akreditimi do të plotësohet deri me 1 janar 2010. Që nga ajo datë labororet duhet të jenë të akredituara siaps standardeve ndërkombëtare.

Niveli, në të cilin situata e sëmundjeve të kafshëve do të ndikojë nëse miratimi mund të merret parasysh, ose çfarë kushtesh janë të lidhura me akreditim, ndryshon varësisht nga lloji i prodhimit shtazor është në fjalë. Për shembull, importimet e kafshëve të gjalla shtëpiake dythundrore nuk kanë qenë të autorizuar nga vendet që vaksinonjë kundër sëmundjes së Aftës Epizootike (FMD), ose ku sëmundja është e pranishme. Në anën tjetër, për produktet e mishit që janë trajtuar plotësisht dhe produktet në bazë të qumështit, kjo nuk do të shkaktonte problem, sepse patogeni shkaktues është shkatërruar me nxemjen adekuate ose tretmanet e tjera të specifikuar ose nga faktorët e tjerë të zvogëlimit të rreziqeve. Detajet e mëtejme janë dhënë në Aneksin që ka të bëjë me importet specifike.

Sistemet e kontrollit të sëmundjeve të kafshëve, funksionimi dhe rezultatet e të cilave duhet të regjistrohen dhe të demonstrueshme, duhet të vendosen. Këto përshembull dihet

të përfshijnë regjistrimin e pronave, identifikimin e kafshëve dhe kontrollat e lëvizjeve (gjurmueshmërinë) ashtu që përputhja me kërkesat e BE-së për qertifikim shëndetësor të mund të konfirmohen. Këto kërkesat të qertifikimit mund të sigurojnë, për shembull, që para therrjes nja kafshë ka kaluar një periudhë të caktuar kohore në farmë dhe në regjion i cili nuk ka sëmundje të caktuara.

Planet e kontingjente për kontrollin dhe/ose asgjësimin e shpërthimit të sëmundjeve nga lista e OiE me rëndësi të madhe duhet të vendosen dhe funksionojnë (natyra dhe niveli i këtyre planeve do të mvaret nga natyra e kafshëve ose produkteve për të cilat miratimi kërkohet).

Për importet e kafshëve të gjalla, një spektër i kontrollave plotësuese të sëmundjeve/programeve të asgjësimit, si dhe testimi për të demonstruar mungesën e sëmundjeve të caktuara, dhe reflektimin e llojit të kafshëve në fjalë, duhet të jenë të vendosura. Detajet e mëtejme mund të shihen në një kapitull të relevant të Aneksit të këtij dokumenti.

Gjithashtu duhet vërejtur se për disa produkte shtazore, kontrollat shtesë të shëndetit të kafshëve ose masat e menagjimit të rrezikut mund të kërkohen ose masat e menagjimit të rrezikut duhet të zbatohen. Për shembull, mishi nga vendet ku FMD vaksinimi praktikohet mund ti nënshtrohet procedurave shtesë të maturimit (përfshirë heqjen nga kocka) për t'i siguruar shkatërrimi i virusit. Në rastet e tjera, p.sh., për menagjimin e gripit të shpezëve/ avian influenza ose etheve klasike të derrit kërkesat minimale të trajtimit janë vendosur për produktet e mishit për të reflektuar situatën e sëmundjeve të kafshëve në vendin në fjalë.

Pa ndonjë kompromis objektivi i përgjithshëm i sigurimit të sigurisë së importit, tregohet fleksibilitet kudo që të jetë e mundur. Për shembull, sa i përket shpërthimeve të sëmundjeve tejet infektive si afta, derisa importet nën kushtet jo të sigurta nuk mund të pranohen por aty ku është e mundshme, principi i regjionalizimit aplikohet. Kjo nënkupton se importet e kafshëve të gjalla dhe produkteve mund të lejohen nga ato regjione të definuara të cilat plotësojnë kërkesat, derisa ndalohen importet nga regjionet e tjera të caktuara në vendet të cilat nuk i plotësojnë. Me fjalë të tjera në rast të shpërthimit të sëmundjes së kafshëve, zbatohen restriksionet në regjionet e prekura, me lëvizje të lira të kafshëve dhe produkteve jasht regjioneve të prekura. Vetëm kafshët ose produktet nga

zonat e pa prekura mund të konsiderohen të përshtatshme për eksport nën kushtet e caktuara. Komunitetet evropiane janë të bindura se regjionalizimi është qasja më e mirë për mbajtjen e kontrollit adekuat të sëmundjeve me ndalesat minimale për tregti.

Për më tepër ekziston gjithashtu mundësia për të importuar kafshë të gjalla të caktuara nga vendet e paautorizuara, meqë është e lejuar të lëvizen ato nga vendi i tyre i lindjes në një vend të tretë që paraqiten në listat me pamje tek lëvizjet pasuese në BE. Me këtë rast një periudhë minimale e qëndrimit në një vend të tretë të autorizuar është gjashtë muaj. Gjithashtu vlen të vërehet se St. Pierre dhe Miquelon është vendi i tretë në listë në të cilin situata është ideale për këtë lloj të importit. Përveçkësaj ai madje ka edhe stacionin e karantinës ku llojet e caktuara të kafshëve mund të rrijnë nën kontroll të kënaqshëm të shërbimeve zyrtare veterinare brenda hapësirave dhe mund të importohen më pas në BE pas 2 muajsh.

Politika importuese e vendit që eksporton, përfshirë edhe kontrollat, edhe situatën shëndetësore të kafshëve në vendet fqinje, do të merren parasysh.

Për të ilustruar zbatimin e këtyre provizioneve në praktikë, lexuesi i referohet kërkesave të detajuara të shëndetit të kafshëve të importuara për kafshët/produktet e vendeve të miratuara tani, të cilat mund të gjenden në qertifikatat model të bashkangjitura në legjislacionin relevant të BE-së në listën e Aneksit të këtij dokumenti.

### **3. KONTROLLAT E MBETJEVE, NDOTËSVE DHE ADITIVËVE**

BE-ja ka të vendosur legjislacion të detajuar për të kontrolluar përdorimin e, dhe monitorimin për, një spektër të gjerë të barnave veterinare dhe substancave të tjera në të gjitha klasat e kafshëve dhe produkteve të synuara për konsum të njerëzve. Kontrollat legale për substancat e ndaluara në lidhje me kafshët dhe produktet e synuara për eksport duhet të jenë të vendosura në vendin e tretë.

Është fundamentale kërkesa për të gjitha shtetet e treta që dëshirojnë të eksportojnë në BE që ato të kenë të vendosur programin monitorues për këto substanca i cili plotëson kërkesat e këtij legjislacioni në lidhje me kafshët dhe/ose produktet e kafshëve në fjalë. Ky program duhet të dorëzohet te Komisioni Evropian ku do të evaluohet dhe nëse evaluimi është i favorshëm, miratohet.

Më pas rezultatet e secilit program vjetor, së bashku me një program të azhurnuar për vitin vijues, duhet të dorëzohet te Komisioni Evropian në baza vjetore.

Pajisjet relevante laboratorike duhet të plotësojnë të njëjtat kërkesa siq janë detajuar në paragrafin e dytë të Seksionit 2.

Mund të jetë e pranueshme për programin monitorues dhe kontrollat e substancave të ndaluara, të limitohen në sektorë specifik dhe ferma individuale. Sidoqoftë, një sistem i tillë i ndarë i eksport-orientuar do të kërkonte të themelohen procedura efektive të regjistrimit, kontrollit, gjurmimit dhe identifikimit, me një sistem të besueshëm, transparent, monitorues në vend. Këto procedura dhe sistem do t'i nënshtroheshin vlerësimit special si pjesë e procesit të miratimit.

#### **4. KONTROLLI MIKROBIOGJIK**

Në mënyrë që të autorizohen për import të kafshëve të gjalla të caktuara dhe vezëve për inkubim, vendet e treta duhet të dorëzojnë një program të kontrollit të *Salmonellaa* për miratim te Komisioni. Kjo kërkesë paraqitet gradualisht për të garantuar një ekvivalencë me kërkesat e Komisionit. Programet e kontrollit duhet të dorëzohen tashmë për import të vezëve për inkubim si dhe për import të zogjëve nje-ditore dhe shumim dhe shpezëve prodhuese të *Gallus gallus* të synuara për shumim ose prodhim të vezëve. Më së voni prej 1 janarit 2008 e tutje, kërkesa e njëjtë vlen për importin e zogjëve nje-ditore për prodhim. Kriteret e sigurisë së ushqimit për disa patogene zoonotike siq janë *Salmonella* dhe *Listeria* vlejné për importin e disa artikujve të caktuar ushqimor.

#### **5. STANDARDET E SIGURISË SË USHQIMIT NË NDËRMARJET E PROCESIMIT**

Standardet në ndërmarjet individuale të propozuara për miratim duhet të jenë të paktën ekvivalente me kërkesat e legjislacionit relevant të BE-së. Këto janë të njëjta si ato të parashtruara për ndërmarjet në Shtetet Anëtare. Legjislacioni kryesor për secilin sektor të prodhimit është dhënë në kapitullin relevant të Aneksit në këtë dokument.

Autoriteti nacional duhet të jetë i sigurtë se standardet e mësipërme janë plotësuar para se ndërmarja të jetë vënë para Komisionit për miratim. Nëse ndodh që rasti nuk është i tillë në cilin do inspektim pasues të bërë atypëraty/në vend, kjo do të reflektohet në mënyrë jo të favorshme në vlerësimin e aftësisë së autoritetit që të shpërndaj standardet e BE-së.

Komisioni ka llojloj proforma të cilat duhet të plotësohen nga autoriteti kompetent për të kërkuar miratimin e ndërmarjeve të procesimit dhe konfirmojë se ato plotësojnë kërkesat relevante të Komunitetit.

Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet instalimit dhe funksionimit të procedurave të përhershme të ndërmarjes të bazuara në principet e HACCP, kontrollat mikrobiologjike dhe sistemin e kontrollit zyrtar efikas, përfshirë regjistrimin e dokumenteve të veprimeve të kontrollit dhe rezultatet e tyre. Që nga 1 Janari 2006, implementimi i sistemeve të kontrollit të bazuara në principet HACCP janë të obligueshme në ndërmarjet e prodhimit, procesimit dhe distribuimit të ushqimit, (përveq për ndërmarjet e involvuara në prodhimin primar).

Për të evituar ndonjë konflikt të interesit dhe mashtrim të mundshëm, zyrtarët në ndërmarjet e procesimit duhet të jenë në gjendje të veprojnë të pavararur nga operatorët. Duhet të ekzistojë një sistem mbikqyrës i këtyre zyrtarëve në nivelet regjionale e qendrore.

Si princip i përgjithshëm, ndërmarrjet duhet të plotësojnë standardet e BE-së gjatë linjave të prodhimit të BE-së, dhe mund të plotësojnë standarde të tjera herave tjera për tregjet e tyre nacionale por një produkt i tillë duhet të mbahet në mënyrë strikte i ndarë nga produkti i destinuar për BE-në. Në të gjitha rastet, kjo çështje duhet qartësuar gjatë vizitave të inspektimit nga Zyra e Ushimit dhe Veterinës.

## **6. KONTROLLAT NË LIDHJE ME BSE**

Regullorja (EC) Nr 999/2001 parashtron rregullat për përcaktimin e statusit të BSE të Shteteve Anëtare, të vendeve të treta dhe regjioneve të tyre të cilat rezultojnë në klasifikimin në tri kategori: rrezik i neglizhuar nga BSE, rrezik i kontrolluar nga BSE dhe rrezik i papërcaktuar nga BSE.

OiE duhet të luaj rol udhëheqës në këtë proces të kategorizimit të vendeve.

Në pritje të rezultatit të vlerësimit të OiE dhe vendimit final mbi statusin e BSE të vendit importues, vendi duhet ti përmbushë kërkesat e importit të zbatueshme për vendet me rrezik të papërcaktuar nga BSE.

Vendimi i Komisionit 2007/453/EC parashtron listën e vendeve sipas statusit të tyre të rrezikut nga BSE në tri kategoritë psh., rrezik i neglizhuar nga BSE, rrezik i kontrolluar nga BSE dhe rrezik i papërcaktuar nga BSE.

Masat e importit për sa i përket të gjitha formave të encefalopative transmiseve spongiforme (TSE) janë parashtruar në Annex IX të Regullores (EC) Nr 999/2001 që parashtron rregullat për parandalimin, kontrollin dhe asgjësimin e encefalopative transmiseve spongiforme (TSE) të caktuara, sipas ndryshimit të fundit. Kërkesat e importit të kafshëve të gjalla, embrioneve, qelizave vezë dhe produkteve me origjinë shtazore në Komunitet janë të bazuara në statusin e rrezikut nga BSE të vendeve dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare të adoptuara në OiE.

## **7. STANDARDET E AUTORITETIT NACIONAL**

Është esenciale që autoriteti nacional (shpesh i referuar si “autoriteti kompetent”) është në gjendje të paraqes nivelin e kërkuar të kontrollave veterinare. Çdo mungesë do të nënkuptonte se miratimi nuk mund të merret parasysh, ose se miratimi ekzistues ndoshta duhet të tërhiqet.

Si pjesë e procesit të miratimit, një pyetësor i detajuar, në lidhje me sektorin për të cilin kërkohet miratimi, i dërgohet autoritetit nacional. Ndër çështjet e ndryshme të ngritura, këto në vijim janë të një rëndësie të veçantë për vlerësimin e performimit të autoritetit:

(1) *Struktura e menagjimit.* Kjo duhet të sigurojë se ekzistojnë lidhjet e komunikimit adekuat në mes të shërbimeve zyrtare qendrore, regjionale e lokale. Autoritetet qendrore, që janë përgjegjëse për standardet, duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë kontrollin e shërbimeve regjionale e lokale.

(2) *Pavarsia.* Shërbimet zyrtare duhet të jenë të pavarura nga presionet e jashtme, dhe duhet të jenë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre pa restriksione të paligjshme. Zyrtarët individual duhet të gëzojnë një status që siguron pavarësinë e tyre nga brengat komerciale, dhe nuk duhet të varen nga ato për bagëtinë e tyre, psh., sduhet të ketë konflikt të interesit dhe duhet të ketë standarde të larta etike.

(3) *Burimet.* Të gjitha nivelet e shërbimeve zyrtare, përfshirë kontrollat kufitare dhe labororet, duhet të kenë personel të mjaftueshëm, burime financiare dhe pajisje për tu lejuar kryerjen e funksioneve të kontrollit.

(4) *Personeli*. I gjithë personeli duhet të gëzojë një status të pavarur brenda shërbimeve zyrtare. Aty ku përdoret personeli i jashtëm, duhet të vendosen marrëveshjet për të siguruar se ata kanë shkallën e njejtë të pavarësisë dhe përgjegjësisë sikur zyrtarët me orar të plotë.

(5) *Rekrutimi dhe trajnimi*. Autoriteti kompetent duhet të jetë në gjendje të tregojë se vedet e lira të punës janë plotësuar me përpikëri, dhe se funksionimi i shërbimeve zyrtare nuk është dëmtuar nga mungesa e personelit të kualifikuar si duhet. Programet e trajnimit, ashtu që personeli të mund të kryej detyrat e tyre si duhet, duhet të vendosen, dhe të regjistrohen në mënyrë të rregullt.

(6) *Fuqitë e zotimi/legale*. Këto duhet të jenë në dispozicion për, dhe të shfrytëzohen nga, shërbimet zyrtare. Fuqitë duhet të ruhen në legjislacionin nacional dhe ti lejojnë këtyre shërbimeve të kryejnë funksionet e kontrollit në mënyrë efikase.

(7) *Prioritizimi dhe dokumentimi i kontrollave*. Shërbimet zyrtare duhet të kenë të vendosura sistemet e shkruara për të prioritetizuar aktivitetet e tyre të kontrollit, duke reflektuar rreziqet e kanosura nga statet e ndryshme të zingjirit të prodhimit. Planifikimi, performimi

12

dhe rezultatet e këtyre kontrollave në nivelet qendrore, regjionale e lokale duhet të regjistrohen ashtu që të mund të demonstrohet përputhja me standardet e BE-së. Në mënyrë ideale, sistemet interne të auditimit duhet të jenë të vendosura për të monitoruar funksionimin e këtyre kontrollave.

(8) *Shërbimet laboratorike*. Duhet të ekzistojë një rrjet laboratorik me burime të përshtatshme, përfshirë një laborator qendror referent, që gëzon një status të pavarur nga prodhuesit/procesuesit, dhe që mbulon tërë vendin. Ai mundet, sidoqoftë, të jetë i pranueshëm për të përdorur pajisjet laboratorike në vendet e tjera ku këto mund të tregohet se ofrojnë nivel të njejtë të shërbimit. Rregullat specifike të BE-së që qeverisin funksionimin dhe mundësitë e këtyre laboreve për sektorët e caktuar të prodhimit duhet të respektohen. Detyrat e rrjetit laboratorik duhet të caktohen qartë, siq duhen edhe procedurat e raportimit kur rezultatet e mos-përputhshme të detektohen. Lidhjet me laboreve ndërkombëtare ose ato të referencës së BE-së duhet të themelohen. Autoriteti qendror kompetent duhet të jetë në gjendje të drejtojë aktivitetet e shërbimit laboratorik të

cilat janë relevante për sektorin e prodhimit në fjalë, madje edhe aty ku nuk është pjesë e strukturës së njejtë të menagjimit. Pajisjet relevante të laboratorit duhet gjithashtu të përmbushin kërkesat e njejta siq janë detajuar në paragrafin e dytë të Seksionit 2.

(9) *Kontrollat e importit.* Duhet të jenë të vendosura konrolla efikase të importit në pikën e hyrjes në vendin e tretë për të mbrojtur statusin shëndetësor të vendit. Këto duhen të kenë personel dhe burime të duhura, dhe të furnizuara me fuqi të nevojshme ligjore për të bërë veprime të kontrollit dhe zbatimit. Në veçanti, pranimi, trajtimi, magazinimi dhe transporti i mëtejme i kafshëve dhe produkteve të synuara për dërgim në BE, ose për përdorim në prodhimtarinë e produktit me status të BE-së, duhet t'i plotësojë kërkesat e BE-së dhe të evitojë rrezikun nga kontaminimi i tërthortë me anë të kafshëve dhe produkteve të jo-pranueshme. Politika e importit e vendit gjithashtu do të vlerësohet për tu siguruar se statusi shëndetësor i vendit nuk rrezikohet.

(10) *Kontrollat e shëndetit të kafshëve.* Duhet të ekzistojë një sistem efikas për detektimin dhe notifikimin e sëmundjeve të kafshëve relevante për eksportin e kafshëve/produkteve. Ky do të duhej të përfshijë masat e vëzhgimit, regjistrimin e fermave, identifikimin e kafshëve dhe kontrollat e lëvizjes, ashtu që përshtatshmëria e kafshëve të përdorura në përpunimin e produkteve me status të BE-së të mund të demonstrohet (gjurmueshmëria). Gjithashtu mund të kërkohet që monitorimi i sëmundjeve dhe programet e kontrollit ose asgjësimit të jenë të vendosura. Njoftimi i saktë i konfirmimit të sëmundjes duhet gjithashtu të demonstrohet.

(11) *Kontrolat e sigurisë së ushqimit.* Detajet e zoonozës të mbuluar nga legjislacioni nacional, dhe veprimet e marra të kontrollit duhet të dorëzohen. Procedurat e koordinimit në mes të autoriteteve të shëndetit të kafshëve dhe atij publik duhet të jenë të vendosura. Sistemet duhet të jenë të vendosura për të regjistruar veprimet e bëra, dhe rezultatet e tyre, kur patogjenët zoonotik të identifikohen. Gjurmueshmëria duhet të sigurohet nëpr tërë procesin e prodhimit të ushqimit me origjinë shtazore.

## **8. PROCEDURA E MIRATIMIT TË VENDIT**

Sekvenca në vijim përcillet në përgjithësi (edhe pse ajo mund të ndryshojë varësisht nga kafsha/produkti në fjalë):

(1) Autoriteti nacional dorëzon një kërkesë formale për miratim të shërbimit të Komisionit. Kjo duhet të përfshijë të paktën informatat në vijim:



- (a) Lloji i kafshës/produktit për të cilin kërkohet miratimi. Detajet e plotë të të gjitha produkteve me origjinë-shtazore duhet të jepen,
  - (b) Vëllimi i parashikuar i tregtisë dhe vendet kryesore të BE-së që importojnë,
  - (c) Klasa e kafshëve (psh. mbarështim, majmëri, therrjr) e involvuar,
  - (d) Përshkrimi i trajtimit minimal (ngrohja, maturimi, acidifikimi etj) që është aplikuar në produkte,
  - (e) Numri dhe lloji i fabrikave që konsiderohet se plotësojnë kërkesat e BE-së,  
Gjithashtu duhet të përfshihet konfirmimi se të gjitha fabrikat e propozuara kënaqin kërkesat e BE\_së. Duhet të jepen referencat e duhura në legjislacionin e BE-së.
- (2) Komisioni pranon kërkesën dhe e dërgon pyetësin relevant para-misionit.
- (3) Autoriteti nacional dorëzon pyetësin e plotësuar, me mbetjet e propozuara që monitorojnë programin për miratim, dhe me kopjet e legjislacionit nacional të zbatueshme për kafshët/produktet në fjalë (nëse përkthimet në anglisht dhe frengjisht sigurohen kjo do të shpejtojë procesimin e dojeve).
- (4) Kontaktet bilaterale në mes të autoriteteve nacionale dhe Komisionit për të zgjidhur çështjet e diskutueshme.
- (5) Nëse Komisioni është i kënaqur me informatat e dhëna, një inspektim aty-për aty (në të shumtën e rasteve) organizohet nga ZUV/FVO.
- (6) Pas kryerjes së inspektimit të ZUV/FVO inspection, një kopje e raportit të tij dërgohet te autoritetet nacionale, shërbimet relevante të Komisionit, Parlamentit Evropian dhe Shtetet Anëtare.<sup>2</sup>
- (7) Nëse rezultati i misionit është i kënaqshëm, dhe qfarëdo çështje tjetër e diskutueshme është zgjidhur, Komisioni përgadit draft legjislacionin:
- (a) për të shtuar vendin e tretë në listën e vendeve të treta prej të cilave importi i kafshëve/produkteve është miratuar;
  - (b) të hartohet nëse është e nevojshme qertifikimi i shëndetit të kafshëve bazuar ne situatën shëndetësore të vendit apo pjesës së vendit për të shoqëruar importet, (një numër i modeleve të qertifikatave shëndetësore veq janë parashtruar në legjislacionin e Komisionit);
  - (c) të miratohet programi i monitorimit të mbetjeve;
  - (d) të bëhet një listë fillestare e ndërmarjeve të miratuara.<sup>3</sup>

Duhet sidoqoftë vërejtur se miratimi i programeve për mbetje, futja e vendit në listën për qëllime të shëndetit të kafshëve, kërkesat për shëndet publik

<sup>2</sup> Raportet e ZUV janë botuar në vebfaqen e DG SANCO:

[http://ec.europa.eu/food/fvo/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/food/fvo/index_en.htm)

<sup>3</sup> Listat e ndërmarrjeve të miratuara tani të sortuara qoftë nga vendi ose nga produkti janë në dispozicion nën:

[http://ec.europa.eu/food/international/trade/third\\_en.htm](http://ec.europa.eu/food/international/trade/third_en.htm)

Procedura mbi atë se si të futen në listën ekzistuese dhe detajet e kontaktimit janë në dispozicion nën:

[http://forum.europa.eu.int/irc/sanco/vets/info/data/listes/new\\_estab\\_lists.htm](http://forum.europa.eu.int/irc/sanco/vets/info/data/listes/new_estab_lists.htm) and later on the neë URL

[http://circa.europa.eu/irc/sanco/vets/info/data/listes/new\\_estab\\_lists.htm](http://circa.europa.eu/irc/sanco/vets/info/data/listes/new_estab_lists.htm)

14

qëllimet dhe listat e ndërmarrjeve të miratuara janë bërë nga shërbime të ndryshme të Komisionit dhe shpesh nën akte të ndryshme ligjore. Paraqitja në njërin prej tyre nuk është parakusht për kyçjen në një listë tjetër. Për shembull kyçja në listën e mbetjeve nuk ndikon në asnjë mënyrë kyçjen e mundshme në listën për shëndetin e kafshëve. Në lidhje me këtë vendi i tretë mund të zgjedhë qasjet e tij se si dhe çfarë rendi të fusin aplikimet për miratim. Disa nga elementet e tij mund të bëhen paralelisht. Në përgjithësi sugjerohet të fillohet me listën për shëndetin e kafshëve sepse zakonisht kjo mund të jetë më e vështira për përmbushje, dhe nuk do të ndikonte në harxhime për të ndërtuar një thertore dhe pastaj të zbuloj se eksporti i mishit nuk mund të autorizohet për arsye të shëndetit të kafshëve.

(8) Tekstet e propozuara legjislativë janë të adaptuara nga Komisioni, dhe të publikuara në Gazetën Zyrtare, pasi që një mendim i favorizuar është pranuar nga komiteti Qëndruar mbi Zingjirin e Ushqimit dhe Shëndetin e Kafshëve.

(9) Nëse data e implementimit nuk është specifikuar në tekstin legjislativ atëherë ajo do të jetë data e njohtimit zyrtar të tekstit nga Komisioni të Shtetet Anëtare.

## **9. PROVISIONET E MIRËQENIES SË KAFSHËVE**

Kërkesat për mirëqenien e kafshëve të BE-së janë gjithashtu të zbatueshme në lidhje me importin e kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore. Ato kanë rëndësi të lartë posaqërisht në dy fusha kryesore e që janë trajtimi i kafshëve gjatë therrjes për konsumim të njerëzve dhe kërkesat e mirëqenies sa i përket transportit të kafshëve të gjalla.

Në lidhje me importin e produkteve të caktuara kërkesat për mirëqenien e kafshëve janë inkorporuar në qertifikatat e importit në formë të një dëshmie dhe autoriteti veterinar i vendit të origjinës duhet të qertifikojë ato së bashku me kërkesat për shëndetin e kafshëve dhe atë publik.

Në lidhje me transportin e kafshëve të gjalla nga vendet e treta kërkesat për mirëqenien e kafshëve janë edhe të inkorporuara në qertifikatat e importit edhe gjithashtu drejtpërsëdrejti zbatohen dhe janë në fuqi nga autoritetet veterinarë të Shteteve Anëtare kur njëherë dërgesa arrin hyrjen në pikën e inspektimit kufitar veterinar PIK (BIP). Në mënyrë që të transportohen kafshët brenda BE-së (përfshirë dërgesat e importit dhe tranzitit) transportuesit duhet të jenë të autorizuar nga SHA/ MS, para-miratimi i makinave është e nevojshme dhe që nga janari 2008 vozitësit kanë nevojë për qertifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtarë ose nga një trup i caktuar nga autoriteti kompetent. Meqë këto dhe kërkesat e tjera të mirëqenies të jenë verifikuar plotësisht në PIK, autoritetet veterinarë në vendin e origjinës duhet të jenë të vetëdijshme për to. Dërgesat të cilat nuk i plotësojnë ato (psh., kafshët e papërshtatshme, kamionët e stërngarkuar, hapësirë e pamjaftueshme për kokë, transportuesi i pautorizuar nga SHA, mungesa e dokumentit të udhëtimit për pjesë të udhëtimit brenda BE etj.,) të paktën do të jenë të penguar.

## **10. QERTIFIKIMI SHËNDETËSOR**

Importet e kafshëve dhe produktet shtazore në BE duhet, si një rregull e përgjithshme, të shoqërohen me qertifikatë shëndetësore të parashtruar në legjislacionin e BE-së. Kjo rradhit kushtet që duhet të kënaqen, dhe verifikimet të cilat do të duhej të jenë ndërmarrë, nëse importet duhet të lejohen. Detajet e qertifikimit të kërkuar janë rradhitur në një legjislacion specifik të BE-së, i cili përfshin modelet e qertifikatave që do të përdoren.

Qertifikata duhet të nënshkruhet nga një veterinar zyrtar ose inspektor zyrtar (siq është shënuar në qertifikatën relevante), dhe duhet të respektojë provizionet e Urdhresës së Këshillit 96/93/EC mbi qertifikimin e kafshëve dhe produkteve shtazore, meqë ato konfirmojnë përmbushjen e rregullave me BE-së. Rregullat strikte i dedikohen prodhimit, nënshkrimit dhe lëshimit të qertifikatave, meqë ato konfirmojnë përmbushjen me rregullat e BE-së. Verzioni origjinal i qertifikatës duhet të shoqërojë dërgesat për hyrjen në Komunitet. Qertifikatat duhet naormalisht të hartohen në gjuhën e vendit të nisjes dhe

që të dyja edhe Shteti Anëtarë në të cilin inspektimi kufitar bëhet edhe këto Shtete Anëtare mund të pajtohen nëse ato dëshirojnë të pranojnë ndonjë gjuhë zyrtare të BE-së tjetër prej të asaj të tyre në ato qertifikata.

Secila kategori e kafshëve dhe produkteve ka numrin e vet të kërkesave të shëndetit të kafshëve dhe/ose publik, të cilat mund ti përfshijë kërkesat e mirëqenies (psh., në trulllosje dhe therrje).

Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet sigurimit të asaj që të përdoret qertifikim korekt, dhe që të gjitha provizionet e tij duhet të plotësohen.

Në disa raste, posaqërisht për import të produkteve anësore të kafshëve të synuara për përdorim teknik, përdorimi i dokumentit komercial dhe/ose një deklaratë nga importuesi lejohet në vend të qertifikatës veterinarë.

## **11. INSPEKTIMI KUFITAR GJATË HYRJES NË BE**

Për hyrjen në Komunitet të dërgesave të importit dhe transportit të kafshëve ose produkteve me origjinë shtazore, ato duhet të hyjnë nëpër Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) të miratuara të vendosura në një Shtet Anëtar. PIK janë të vendosura nën autoritetin e veterinarëve zyrtar, që në mënyrë efektive janë përgjegjës për verifikimet e shëndetit të dërgesave që vijnë.

Sipas legjislacionit të Komunitetit secila dërgesë e kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore duhet ti nënshtrohet verifikimeve zyrtare veterinarë në inspektimin kufitar. Kontrollat zyrtare përfshijnë të paktën një verifikim sistematik të dokumenteve, verifikim të identitetit, nëse është e përshtatshme, edhe një verifikim fizik. Në disa raste frekvenca e verifikimeve fizike mund të reduktohet dhe ato varen nga nga profili i rrezikut të produktit dhe gjithashtu nga rezultatet e verifikimeve të mëparshme.

Edhe pse aspektet procedurale të hyrjes së dërgesave janë kryesisht përgjegjësi e importuesit ose siq është shpesh rast, ndahet ndërmjet importuesit, eksportuesit dhe transportuesit përfshirë agjentët e tjerë, duhet të përmendet se dërgesat e kafshëve të gjalla duhet të para-lajmërohen tek PIK 24 orë para arritjes dhe dërgesat e produkteve para arritjes në PIK me pjesën e parë të së ashtuquajturave dokumente të zakonshme veterinarë për hyrje (CVED) të plotësuara siq duhet. Falë aplikimit kompjuterik veterinar të zhvilluar para pak kohësh (TRAdE Control and Expert System, TRACES/Kontrolli i tregut dhe sistemi i ekspertëve) kjo gjithashtu mund të bëhet me transmetim elektronik.

Ekziston legjislacioni i zgjeruar i BE-së që ka të bëjë me shumë aspekte të tjera të procedurave të hyrjes.

Dërgesat të cilat zbulohet se nuk përmbushin legjislacionin e Komunitetit ose do të asgjësohen ose, nën kushte të caktuara, ri-nisen brenda 60 ditësh. Nëse ndonjëri prej verifikimeve sidoqoftë tregon se dërgesa e kafshëve apo produkteve ka gjasa të përbëjë rrezik për shëndetin e kafshëve apo njeriut, dërgesa në fjalë do të konfiskohet dhe asgjësohet nga autoritetet kompetente menjëherë.

16

## **12. KËRKESAT PËR TRANZIT**

Në përgjithësi dhe në pajtim me rregullat e shëndetit të kafshëve të parashtruara në legjislacionin e ndryshëm sektorial, dërgesat e kafshëve të gjalla dhe produktet shtazore në tranzit ose në rastin e produkteve, përkohësisht të magazinuara në BE duhet të përmbushin kërkesat e BE-së për shëndet të kafshëve. Kjo përmbushje verifikohet gjatë hyrjes në PIK dhe kërkohet qertifikata specifike. Rregullat relevante të detajuara janë të përmbajtura në listën e legjislacionit të dhënë në Aneks. Kjo ka të bëjë vetëm me kërkesat e shëndetit të kafshëve meqë nuk ekzistojnë kërkesa për rranzit dhe/ose magazinim për shëndet publik.

## **13. IMPORTET PERSONALE**

*OJ Nr. L 361, 08.12.2004, f. 40*

## 16.10. Legjislacioni në lidhje me proceduart në pikat e inspektimit kufitar (PIK)

<p>Vendimi i Komisionit 94/360/EC e 20 majit 1994 ombi <b>frekvencën e zvogëluar të verifikimeve fizike</b> të ngrkesave të produkteve të caktuar të implementohet nga vendet e treta, nën Urdhëresën e Këshillit 90/675/EEC (OJ Nr. L 158, 25/06/94, f. 41)</p>
<p>Vendimi i Komisionit 97/794/EC i 12 nëntorit 1997 që parashtron rregullat e caktuara të detajuara për zbatimin e Urdhëresës së Këshillit 91/496/EEC sa i përket <b>verifikimeve veterinare të kafshëve të gjalla</b> që do të importohen nga vendet e treta (OJ Nr. L 323, 26.11.97, f. 31)</p>
<p>Vendimi i Komisionit 2000/25/EC i 16 dhjetorit 1999 që vendos rregullat e detajuara për zbatimin e Nenit 9 të Urdhëresës së Këshillit 97/78/EC në lidhje me <b>transportit e produkteve</b> në Pikën e Inspektimit Kufitar ku ngarkesat synohen për ndonjë import eventual në Komunitetin Evropian, dhe ndryshimin e Vendimit të Komisionit 93/14/EEC (OJ Nr. L 9, 13.01.2000, f. 27)</p>
<p>Vendimi i Komisionit 2000/208/EC i 24 shkurtit 2000 që vendos rregullat e detajuara për zbatimin e Urdhëresës së Këshillit 97/78/EC në lidhje me <b>transportimin e produkteve</b> me origjinë shtazore nga një vend i tretë në një vend tjetër të tretë me rrugë vetëm nëpër Komunitetin Evropian (OJ Nr. L 64, 11.03.2000, f. 20)</p>
<p>Vendimi i Komisionit 2000/571/EC i 8 shtatorit 2000 që parashtron metodat e verifikimeve veterinare për produktet nga vendet e treta të destinuara për hyrje në <b>zonat e lira, depot e lira, depot e doganave</b> ose operatorët që sigurojnë mjetet tejkufitare për transport detar (OJ Nr. L 240, 23.09.2000, f. 14)</p>

<p>Vendimi i Komisionit 2001/881/EC i 7 dhjetorit 2001 që harton <b>listën e pikave kufitare të inspektimit</b> të miratuara për verifikime veterinare mbi kafshët dhe produkteve shtazore nga vendet e treta dhe azhurnimin e rregullave të detajuara në lidhje me verifikimet që duhet të bëhen nga ekspertët e Komisionit (OJ Nr. L 326, 11.12.2001, f. 44)</p>
<p>Regullorja e Komisionit (EC) Nr 136/2004 e 22 janarit 2004 që parashtron procedurat për <b>verifikimet veterinare</b> në pikat e inspektimit kufitar të Komunitetit <b>mbi produktet e</b> importuara nga vendet e treta (OJ Nr. L 21, 28.01.2004, f. 11)</p>
<p>Regullorja e Komisionit (EC) Nr 282/2004 e 18 shkurtit 2004 që fut në përdorim <b>dokumentin për</b> deklarimin e, dhe verifikimin veterinar të, <b>kafshëve</b> nga vendet e treta që hyjnë në Komunitet (OJ Nr. L 49, 19.02.2004, f. 11)</p>
<p>Vendimi i Komisionit 2004/292/EC i 30 marsit 2004 mbi futjen në përdorim të sistemit të <b>Gjurmëve</b> dhe ndryshimin e Vendimit 92/486/EEC (OJ Nr. L 94, 31.03.2004, f. 63)</p>
<p>Regullorja e Komisionit (EC) Nr 745/2004 e 16 prillit 2004 që parashtron masat në lidhje me importet e produkteve me origjinë shtazore për <b>konzum personal</b> (OJ Nr. L 122, 26.04.2004, f. 1)</p>
<p>Vendimi i Komisionit 2005/92/EC i 2 shkurtit 2005 sa i përket kushteve të shëndetit të kafshëve, provizioneve të qertifikimit dhe transportit në lidhje me hyrjen dhe periudhën e magazinimit për ngarkesat e produkteve të caktuara me origjinë shtazore në zonat e lira, depot e lira dhe hapësirat e operatorëve që sigurojnë mjetet tejkufitare për transport detar në Komunitet (OJ Nr. L 31, 04.02.2005, f. 62)</p>
<p>Vendimi i Komisionit 2005/93/EC i 2 shkurtit 2005 sa i përket provizioneve të transportit në lidhje me hyrjen dhe periudhën e magazinimit për ngarkesat e produkteve të caktuara me origjinë shtazore në depot e doganave në Komunitet (OJ Nr. L 31, 04.02.2005, f. 64)</p>

Vendimi i Komisionit 2007/275/EC i 17 prillit 2007 në lidhje me **listat e kafshëve dhe produkteve që do të nënshtrohen kontrollave** në pikat e inspektimit kufitar nën Urdhëresën e Këshillit 91/496/EEC dhe 97/78/EC  
(OJ Nr. L 11, 04.05.2007, f. 9)

32

## 16.11. Legjislacioni zooteknik

Urdhëresa e Këshillit 94/28/EC e 23 qershorit 1994 që parashtron **principlet në lidhje me kushtet zooteknike dhe gjenealogjike** të zbatueshme për importet nga vendet e treta të kafshëve, materialit të tyre për shumim, qelizave vezë dhe embrioneve, dhe ndryshimit të Urdhëresës 77/504/EEC mbi **kafshët e rasës së pastërt** të llojit të gjedhit  
(OJ Nr. L 178, 12.07.1994, f. 66)

Vendimi i Komisionit 96/509/EC i 18 korrikut 1996 që parashtron pedigrenë dhe kërkesat zooteknike për importim **të materialit për shumim** të kafshëve të caktuara  
(OJ Nr L 210, 20.6.1996, f. 47)

Vendimi i Komisionit 96/510/EC i 18 korrikut 1996 që parashtron qertifikatat për pedigree dhe ato zooteknike për importimin e **kafshëve për mbarështim, materialit të tyre për shumim, qelizave vezë dhe embrioneve**  
(OJ Nr L 210, 20.6.1996, f. 53)

Vendimi i Komisionit 2006/139/EC i 7 shkurtit 2006 që implementon Urdhëresën e Këshillit 94/28/EC sa i përket një liste të autoriteteve në vendet e treta të miratuara që të **mbajnë librin e kullosave ose regjistrin** e kafshëve të caktuara  
(OJ Nr L 54, 24.2.2006, f. 34)

## 17. PYETËSORI PARA-MISIONIT

### **SHEMBULL – PYETËSORI PARA-MISIONIT (përjashton shpezët ose peshkun) KONTROLLAT VETERINARE, TË SIGURISË SË USHQIMIT DHE SHËNDETIT TË KAFSHËVE TË VENDEVE TË TRETA**

#### **Vërejtje autoriteteve kompetente**

Ky pyetësor duhet të plotësohet dhe të kthehet sa më parë të jetë e mundur tek:

C Gaynor

Drejtor

Zyra e Ushqimit dhe Veterinës

Grange, Dunsany

Co. Meath

Ireland

(Fax: 00 353 46 90 61 701)

Aty ku në disa pyetje përgjegjet nuk mund të jenë të plota, kjo duhet të tregohet qartë, dhe informatat që mungojnë të sigurohen para fillimit të misionit të ZUV.

34

#### **1. INFORMATAT E PËRGJITHSHME**

##### **1.1. Emri i vendit .....**

##### **1.2. Çështjet gjeografike**

Ju lutemi siguroni një hartë të ..... që tregon veçoritë në vijim:

- kufijtë nacional
- kufijtë e brendshëm administrativ (regjional dhe lokal)
- kufijtë e çdo zone të miratuar të kontrollit të sëmundjeve (regjionalizimi)
- qytetet kryesore
- rrugët kryesore/hekurudhat
- veçoritë kryesore gjeografike (lumenjtë, vargmalet)
- pozita e:

Zyra e Qendrore të Sherbimeve Shtetërore të Veterinës (SHSHV)

zyret regjionale dhe lokale të SHSHV

laboratorët qendrore dhe regjionale

□ pikat e inspektimit kufitar të miratuara (aeroportet, portet detare, kufijtë tokësorë)

## **2. POPULLATA E BAGËTISË**

Ju lutemi plotësoni tabelën për numrin e pronave dhe bagëtisë në Aneksin I të këtij raporti (informatat duhet dhënë për 3 vitet e fundit):

## **3. LEGJISLACIONI**

Jepni titujt e legjislacionit nacional i cili konsiderohet se ofron garancat ekuivalente të kontrollave të shëndetit me ato të parashtruara në legjislacionin relevant të BE-së (duke shënuar titullin dhe emrin e legjislacionit të BE-së në secilin rast) për secilin seksion të përfshirë në këtë pyetësor. Këto duhet të tregojnë qartë kafshët dhe komoditetet e mbuluara nga legjislacioni i cituar. Legjislacioni që kontrollon shfrytëzimin dhe distribuimin e barnave veterinarë dhe gjërave ushqimore të medikamentuara, monitorimi i mbetjeve dhe lejimi i Limiteve maksimale të Mbetjeve (MRLs) duhet të përfshihen.

Kopjet e legjislacionit të mësipërm duhet të sigurohen.

## **4. SITUATA E SHËNDETIT TË KAFSHËVE**

### **4.1. Legjislacioni i shëndetit të kafshëve**

- (1) Trego llojet e mbuluara me definicionin e “bagëtisë”.
- (2) Jep një listë të sëmundjeve që duhen të regjistrohen(OiE lista, të tjera)
- (3) Jep detajet e obligimeve ligjore për të lajmëruar dyshimin e epidemive/shpërthimeve të sëmundjeve në listën e OiE.
- (4) Jep detajet e çdo kërkesë ligjore për kontroll dhe asgjësim të sëmundjeve në listën e OiE.
- (5) Jep detajet e çdo kompenzimi me të holla që i është bërë e mundur farmerëve etj kur kafshët janë therrë për qëllime të kontrollit të sëmundjes/asgjësimit.

### **4.2. Kontrollat rutinore të shëndetit të kafshëve**

- (1) Përshkruaj çdo program të monitorimit rutinor për praninë e sëmundjeve në listën e OiE .
- (2) jep detaje të kontrollave për përdorim, ushqim të kafshëve dhe hedhjen e ushqimit të tepërt, duke përfshirë kontrollat e ushqimit të tepërt që vjen nga transporti ndërkombëtar.



(3) Jep detajet e çdo programi të vaksinimit në funksion sa i përket sëmundjeve në listën e OiE.

### **4.3. Lajmërimi i sëmundjeve**

Përshkruaj procedurat ekzistuese për lajmërim të:

- OiE
- Komisionit Evropian

për shpërthimin e sëmundjeve A në listën e vjetër të OiE .

Nëse nuk ekzistojnë tash për tash procedura të tilla, trego çfarë veprimesh do të ndërmerren për të siguruar lajmërimin në të ardhmen, dhe trego orarin për implementimin e tyre

*NB. Anëtarësimi në OiE, dhe një zotim për të lajmëruar shpërthimet/epidemitë e sëmundjeve A të listës së vjetër të OiE-së tek komisioni Evropian dhe Shtetet Anëtare është kërkesë për të gjitha vendet e treta që kërkojnë të eksportojnë në Bashkimin Evropian).*

(4) Çfarë veprimi kërkohet nga fermerët, veterinarët privat, etj të cilët dyshojnë në epideminë e ndonjë sëmundjeje a të listës së vjetër të OiE?

(5) Jep datat dhe detajet e epidemive të të gjitha sëmundjeve në listën e OE brenda pesë vjetëve të fundit.

- në popullatën e bagëtisë së fermave
- në popullatën e kafshëve të egra

### **4.4. Epidemitë e sëmundjeve (sëmundjet A të listës së vjetër të OiE-së)**

(1) jep detajet e çdo udhëzimi të shkruar që është në dispozicion të shërbimeve zyrtare për marrjen me epidemitë e sëmundjeve A të listës së vjetër të OiE.

(2) Në rast të epidemisë së ndonjë sëmundjeje A të listës së vjetër të OiE:

- trego mbledhjeostrat dhe procedurat e testimit të përdorura për identifikimin dhe konfirmimin e pranisë së agjentit shkaktues.
- përshkruaj veprimet e marra për të kontrolluar situatën e sëmundjes në dhe rreth çdo farme që gjindet se është e infektuar me një sëmundje A të listës së vjetër të OiE (ku kjo ndryshon me sëmundjen në fjalë, dallimi duhet të sinjalizohet qartë).

–trego kontrollin dhe/ose procedurat e asgjësimit (psh., vaksinimi, vulosjen, therjen parciale/vaksinimin etj) që do të ndërmerreshin.

– përshkruaj procedurat e përdorura për të konfirmuar se epidemia ka qenë në mënyrë të suksesshme e kontrolluar/asgjësuar, duke përfshirë çdo restriksion në ribagëtimin/ripopullimin.

(3) Jep detajet për praninë e çdo vektori të popullatës që mund të ndihmojnë përhapjen sëmundjeve A të listës së vjetër të OiE.

(4) Nëse sëmundjet A të listës së vjetër të OiE-së gjinden vetëm në ndonjë pjesë të vendit, ju lutemi tregoni arsyet (psh kufijtë natyrorë, intervenimi nga shërbimet zyrtare etj) pse kjo konsiderohet të jetë rast. Detajet e çdo bariere artificiale të brendshme, psh., gardhet e gjahut etj, duhet të ofrohen.

#### **4.5. Vaksinimi**

(1) Përshkruaj rregullat ligjore të zbatueshme për përdorim të vaksinimit kundër sëmundjeve të kafshëve.

(2) Jep detajet e plota të çdo programi të vaksinimit rutinor kundër sëmundjeve në listën e OiE.

(3)Ku ushtrohet vaksinimi, jep detajet e çdo kontrolli për tipin (psh gjallë, vdekur), dëmet, prodhimin, përdorimin, magazinimin dhe distribuimin.

#### **4.6. Verifikimet para-eksportit**

(1) Verifikimet e bëra në farmat e origjinës në raport me statusin e shëndetit të kafshëve

### **5. SISTEMET E KONTROLLIT TË AUTORITETIT KOMPETENT**

#### **5.1. Strukturat e menaxhimit**

Jep emrin, përgjegjësitë dhe detajet e kontaktimit për Drejtorët e:

– Shërbimeve të Shëndetit të Kafshëve

– Shërbimeve të Shëndetit Publik (sigurisë së ushqimit)

–Kontrollave të barnave veterinarë dhe artikujve ushqimor të medikamentuar

– Shërbimeve Laboratorike

(1) Përshkruaj strukturën e shërbimeve të mësipërme, dhe ofro një organigram të secilit shërbim. Procedurat për koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet shërbimeve të mësipërme duhet jepen. Vijat e menaxhimit nga shërbimet qendrore te ato regjionale te ato lokale duhet të tregohen qartë.

(2) Trego kujt i raportojnë Drejtorët, dhe raportin e tyre me Ministrat relevant të qeverisë.

## **5.2. Pavarësia e shërbimeve zyrtare**

(1) Përshkruaj procedurat që janë të vendosura për sigurimin e pavarësisë së shërbimeve të sipërpërmendura.

(2) Çfarë lidhjesh ekzistojnë në mes të shërbimeve zyrtare dhe organeve private ose kuaziqeveritare?

(3) Çfarë fuqi të hetimit dhe zbatimit i janë dhënë shërbimeve zyrtare?

## **5.3. Burimet**

*NB. Informatat në vijim duhet të jepet ndaras për nivelet qendrore, regjionale dhe lokale të shërbimeve zyrtare.*

(1) Financiare

–Trego buxhetin në dispozicion për funksionimin e kontrollave rutinore të shëndetësisë, të çdo programi special të shëndetësisë dhe për marrjen me emergjencat shëndetësore.

– Trego proporcionin e buxhetit të ofruar nga qeveria, dhe atë të ofruar nga burimet e tjera (statusi i çdo burimi tjetër duhet të tregohet qartë).

(2) Personelit

Plotëso tabelat në vijim.

Personeli i përhershëm						
	Personeli Veterinar		Personeli Administrativ		Personeli Teknik*	
	Vendet e plotësuaratë punës	Vendet e lira të punës	Vendet e plotësuaratë punës	Vendet e lira të punës	Vendet e plotësuaratë punës	Vendet e lira të punës
Shërbimi qendror						
Shërbimi regjional						
Shërbimi lokal						
Kontrollat kufitare						

Shërbimi laboratorik						
- laboratori qendror						
-laboratori regjional						

\* Personeli i punësuar si ndihmës për shëndetin e kafshëve ose shëndetin publik, që vepron si mbështetje e personelit veterinar për kryerjen e punëve teknike

<b>Personeli me kontratë dhe i përkohshëm</b>						
	<b>Personeli Veterinar</b>		<b>Personeli Administrativ</b>		<b>Personeli Teknik*</b>	
	Vendet e plotësuara të punës	Vendet e lira të punës	Vendet e plotësuara të punës	Vendet e lira të punës	Vendet e plotësuara të punës	Vendet e lira të punës
Sherbimet qendrore						
Sherbimet regjionale						
Shërbimi lokal						
Kontrollat kufitare						
* Personeli i punësuar si ndihmës për shëndetin e kafshëve ose shëndetin publik, që vepron si mbështetje e personelit veterinar për kryerjen e punëve teknike						

### (3) Pajisjet

Tregoni llojin dhe sasinë e pajisjes (psh. makinat, radiot, pajisjet e kontrollit të sëmundjeve, sprejet dezinfektues, pajisjet humane për therrje, rrobat mbrojtëse etj.) në dispozicion tek zyret regjionale dhe lokale për kryerjen e kontrollave rutinore dhe emergjente.

#### **5.4. Personeli**

Çfarë rregullash vlejnë për aktivitetet private/profesionale të zyrtarëve permanent (veterinarëve dhe ndihmësve) jasht detyrave të tyre zyrtare?

Cilat detyra zyrtare mund të ndërmerren nga veterinarët/ndihmësit privat?

Çfarë rregullash janë vendosur për të siguruar pavarësinë e veterinarëve/ndihmësve privat që kryejnë detyrat zyrtare?

#### **5.5. Rekrutimi & trainimi**

Përshkruaj procedurat e rekrutimit për personelin veterinar dhe teknik.

Përshkruaj kualifikimet minimale (dhe vitet e përvojës, aty ku është e përshtatshme) që kërkohen për personelin veterinar dhe teknik.

39

Jepni detajet e programeve të trajnimeve rutinore ose speciale që janë ë dispozicion për personelin veterinar dhe teknik rishtazi të punësuar dhe të themeluar.

Jepni detajet e aranzhimeve për zhvillim të vazhdueshëm profesional të personelit veterinar dhe teknik.

### **5.6. Fuqitë e zbatimit/ligjore**

Trego fuqitë e zbatimit dhe sanksionet në dispozicion në rast të mospajtimit me legjislacionin nacional. Kjo duhet të tregojë cila/t degë të shërbimeve zyrtare ka/në fuqinë të fillojnë dhe vazhdojnë ndjekjet penale.

Ofro detajet e të gjitha ndjekjet penale, dhe rezultetet e tyre, të ndërmara nga shërbimet zyrtare në sektorët e veterinars dhe sigurisë së ushqimit në tre vitet e fundit.

### **5.7. Prioritizimi i kontrollave (programet rutinore)**

Përshkruaj çdo sistem formal, të shkruar për identifikimin dhe prioritizimin e kontrollave veterinare dhe të sigurimit të ushqimit të opruara nga shërbimet zyrtare.

Shembujt e këtij sistemi duhet të ofrohen, me referim të veçantë në sektorët për të cilat miratimi i KE kërkohet.

Trego nëse janë ndërmarrë inspektimet e rregullta të sistemeve të prioritizimit.

Detajet e frekvencës dhe natyrës së këtyre inspektimeve duhet të ofrohen.

Përshkruaj procedurat e modifikimit të sistemit të prioritizimit që të merren parasysh ndryshimet në situatën e shëndetit, dhe/ose rezultatet e gjetjeve të kontrollave zyrtare.

### **5.8. Dokumentacioni i kontrallave (programet rutinore)**

Ofro detajet e programeve të shkruara të kontrollave zyrtare në nivelet nacionale, regjionale e lokale.

Ofro shembuj të rezultateve të dokumentuara të këtyre programeve, dhe të veprimeve të marruna si përgjegje ndaj këtyre rezultateve.

Ofro detajet e çdo sistemi të auditit intern dhe të jashtëm të hartuar për monitorimin e funksionimit të këtyre programeve të kontrollit.

## **5.9. Shërbimi laboratorik**

*NB. Shih gjithashtu seksionin 11 të pyetësorit, që ka të bëjë me çështjet specifike laboratorike.*

Trego numrin dhe vendet e laboratorëve të përfshirë në cilindo rrjet zyrtar.

Statusi i laboratorëve (privat/zyrtar) duhet të jepet. Përshkruaj detyrat e laboratorit qendror dhe laboreve regjionale/lokale në sektoret veterinare dhe sigurisë së ushqimit.

Përshkruaj strukturën e menaxhmentit të shërbimit laboratorik, dhe raportin e tij me shërbime veterinare qendrore.

Përshkruaj çdo lidhje me laboratorët referencialë ndërkombëtarë ose të BE-së. Kjo do të duhej të përfshijë pjesëmarrjen në testet rrethore, shkëmbimin e zyrtarëve etj.

## **5.10. Kontrollat e Importit**

*NB. Ky seksion lidhet me funksionimin e kontrollave mbi importimin e kafshëve dhe produkteve shtazore në vendin e tretë. Shih gjithashtu seksionin 10 të pyetësorit, që merret me çështjet specifike të kontrollit të importit*

A është shërbimi zyrtar përgjegjës për kontrollin e importeve pjesë e shërbimeve zyrtare të përshkruara në seksionin 5.1, apo është organ i pavarur?

Nëse është organ i pavarur, përshkruaj strukturën e tij të menaxhimit, nivelet e personelit dhe burimet, dhe besueshmërinë e tij tek shërbimet veterinare qendrore.

Përshkruaj sistemet e komunikimit në mes të autoriteteve qendrore dhe pikave të inspektimit kufitar, dhe ndërmjet pikave të inspektimit kufitar.

Si importohen produktet e destinuar për përdorim në fabrika të BE-së-eksportohen produktet e përshtatshme të identifikuar?

## **5.11. Lajmërimi i sëmundjes së kafshëve & sistemet e kontrollit**

*NB. Shih gjithashtu seksionin 4 të pyetësorit, që merret me çështjet specifike të shëndetit të kafshëve.*

Trego cilat sëmundje nga lista e OIE i nënshtrohen kontrollave zyrtare.

Trego kërkesat ligjore për njohtimin e dyshimit dhe/ose epidemitë e sëmundjeve të mësipërme.

Jep detajet e çdo programi të vëzhgimit rutinor për sëmundjet e mësipërme.

Jep detajet e çdo programi të dokumentuar për t'iu përgjegjur epidemive të listës së vjetër të OiE të A sëmundjeve.

### **5.12. Kontrollat e sigurisë së ushqimit kimik**

*NB. Shih gjithashtu seksionin 13 të pyetësorit, që merret me çështjet specifike të sigurisë së ushqimit.*

Trego cilat rreziqe kimike nga ushqimi kërkohet të lajmërohen te shërbimet zyrtare Përshkruaj procedurat e vendosura për bashkëpunim/kordinim në mes të Ministrive/Agjensioneve përgjegjëse kur një sëmundje nga ushqimi prej rrezikut kimik është identifikuar qoftë në popullatën e njerëzve apo të kafshëve.

Jepni detajet e çdo programi të dokumentuar për tu përgjegjur ndaj sëmundjes nga ushqimi prej një rreziku kimik.

Përshkruaj sistemin e vendosur për regjistrimin e sëmundjeve nga ushqimi prej një rreziku kimik.

### **5.13. Kontrollat mikrobiologjike të sigurisë së ushqimit**

(1) Përshkruaj çdo program monitorues dhe/ose të kontrollit në funksion të agjentëve zoonotik në kafshë dhe artikuj ushqimorë.

(2) Jep detajet e legjislacionit nacional që mbulon:

– obligimin për të lajmëruar rastet e dyshuara/konfirmuara në ushimin e kafshëve, kafshë dhe artikuj ushqimorë

– veprimet që kërkohen nga farmerët, veterinarët privat, etj

– veprimet që kërkohen nga shërbimet zyrtare

(3) Jepni rezultatet e sistemeve të regjistrimit për rastet zoonotike në ushimin e kafshëve, kafshët dhe artikujt ushqimor në tri vitet e fundit nga sëmundjet nga ushqimi .

(4) jepni detajet për çdo plan të dokumentuar të shkarkimeve, dhe procedurat e vendosura, për hulumtimin dhe kontrollin e epidemive zoonotike nga sëmundjet nga ushqimi (2 apo më shumë raste të lidhura me burimin e njejtë të infektimit) në popullatën e njerëzve.

(5) jepni detajet e kampanjave rutinore ose emergjente për vetëdijësimin e konsumatorit.

### **5.14. Kontrollat e mbetjeve**



Aty ku nuk është bërë ende, ju lutemi sigurojeni një kopje të programit nacional të monitorimit të mbetjeve për plotësimin e provizioneve të Urdhëresës së Këshillit 96/23/EC.

### **5.15. Kontrollat mbi përdorimin dhe distribuimin e barnave veterinare**

(1) A është shitja, ose përdorimi i ndonjë lloji të kafshe, i stilbenes ose substancave që kanë veprim tirostatik të lejuar? (Shih Urdhëresën e Këshillit 96/22/EC).

(2) Cilat barna veterinare janë të ndaluara për përdorim në kafshët për prodhim të ushqimit (përfshirë ekuidat)? A është shitja ose administrimi i substancave që kanë veprim ostrogjenik, androgjenik, gestagjenik ose beta-agonistëve të kafshët e farmës e lejuar? Nëse po, nën cilat kushte?

(3) Cilat barna veterinare janë ‘barna vetëm me reqetë’? Çfarë provizionesh ekzistojnë në legjislacion sa i përket “extra përdorimit të etiketës” të barnave veterinare në kafshët për prodhim ushqimor?

(4) Aty ku përdorimi i Promotorve Hormonal të Rritjes lejohet, përshkruaj çdo sistem të vendosur për të identifikuar kafshët e prodhuara pa përdorimin e tyre.

(5) Përshkruaj kontrollat në prodhimin dhe distribuimin e artikujve ushqimor të medikamentuar.

(6) Ofro një listë (vademecum) të të gjitha barnave të regjistruara të autorizuara veterinare dhe premikseve për artikujt ushqimor të medikamentuar me emrin e barit veterinar, substancës aktive, llojit të tretmanit (oral, injektim etc.), periudhën e tërheqjes dhe cilat lloje janë në fjalë.

### **6. REGJISTRIMI I FARMAVE**

(1) Përshkruaj sistemin e përdorur për regjistrim e pronave të bagëtisë. Çdo shkarkim nga ky sistem duhet të tregohet qartë.

(2) Përshkruaj metodat e përdorura për identifikim të pronave individuale.

(3) Përshkruaj sistemin për protokollimin e regjistrimeve të farmave.

### **7. IDENTIFIKIMI I KAFSHËVE**

(1) Përshkruaj sistemin për identifikimin e të gjitha klasëve të kafshëve të farmave (lopë, dele, dhi, derra). Çdo shkarkim nga ky sistem duhet të tregohet qartë. Informatat mbi sistemin e regjistrimit për identifikimin e kafshëve duhet të jepen. Posqërisht, jep detajet e llojit të shenjës së përdorur (etiketat, tatutë etj), se a lejojnë atë kafshët individuale apo

vetëm identifikim e farmave, moshën maksimale të kafshëve në identifikimin e parë, përgjegjësinë për aplikimin e shenjave, mbi farmën dhe regjistrat zyrtare të shenjave, ri-aplikimi i shenjave të humbura, shenjat speciale për kafshët e dyshimta ose të sëmuara etj.

(2) tregoni çdo rregull speciale për identifikimin e kafshëve me pedigree.

(3) Përshkruaj kontrollat zyrtare dhe dokumentete mbajtura për të monitoruar funksionimin e sistemeve të identifikimit të kafshëve.

(4) tregoni se si sistemi lejon gjurmimin mbrapa të kafshëve dhe karkaseve deri te farma e origjinës.

## **8. KONTROLLAT E LËVIZJES**

(1) Çfarë kontrollash ekzistojnë për lëvizjen e kafshëve dhe produkteve shtazore ndërmjet regjioneve me status të ndryshëm të shëndetit?

(2) Trego nëse ekziston ndonjë sistem zyrtar për autorizimin e lëvizjeve të kafshëve.

(3) Jepni detajet për çdo kërkesë për regjistrimin e lëvizjeve të kafshëve (qoftë nga farmerët, autoritetet e tregut ose shërbimet zyrtare).

(4) Çfarë kontrollash shtesë aplikohen te kafshët me status të njohur zyrtarisht për pastërti nga sëmundja?

(5) Çfarë kontrollash shtesë aplikohen te kafshët e nisura nga farmat të cilat nuk janë njohur zyrtarisht se janë pastra nga sëmundjet specifike?

43

(6) Përshkruaj sistemin për azhurnimin dhe verifikimin e regjistrit të lëvizjeve të regjistruara.

(7) Përshkruaj sistemin për regjistrimin e lëvizjeve të kafshëve në dhe jashtë tregjeve, dhe procedurat e vendosura për mënjanimin e kontaktit ndërmjet kafshëve me status të ndryshëm shëndetësor.

(8) Jepni detajet e çdo sistemi për regjistrimin dhe autorizimin e makinave dhe të sipërmarjeve të transportit të bagëtisë.

(9) Çfarë regjistrash të lëvizjes së kafshëve kërkohet të mbajnë transportuesit?

## **9. QERTIFIKIMI**

(1) Përshkruaj kontrollat zyrtare për printimin, magazinimin dhe distribuimin e qertifikatave të zbrazëta. Veçanërisht, kush është përgjegjës për të mbajtur rezervat e kopjeve të zbrazëta të qertifikatave?

- (2) Përshkruaj procedurat për plotësimin e qertifikatave.
- (3) përshkruaj procedurat për nënshkrimin e qertifikatave. Posaqërisht, kush është përgjegjës për nënshkrim?
- (4) Përshkruaj procedurat për tërheqjen ose ndryshimin e qertifikatave të nënshkuara.
- (5) Jepni detajet për çdo udhëzim të shkruar që është në dispozicion të zyrtarëve për qertifikim.
- (6) Jepni detajet se kush është përgjegjës për prodhimin dhe verifikimin e dokumenteve mbështetëse për qertifikata.
- (7) Përshkruaj procedurat që duhet ndjekur kur qertifikata përfundimtare e shëndetësisë e cila shoqëron ngarkesat e eksportuara në BE prodhohet dhe nënshkruhet.
- (8) Përshkruaj kontrollat mbi lëvizjen e ngarkesave brenda vendit para eksportimit final në BE.

## **10. KONTROLLAT E IMPORTIT**

*NB. Ky seksion ka lidhje me funksionimin e kontrollave mbi importimin e kafshëve dhe produkteve shtazore në vendin e tretë.*

- (1) Përshkruaj kontrollat e përgjithshme mbi importimin e kafshëve të gjalla dhe produkteve shtazore (legjislacionin, vendet e miratuara dhe ndërmarjet e përpunimit, dhënja e lejeve të importimit, kërkesat për karantinë, garancat për shëndet të kafshëve dhe shëndet publik, qertifikimi, testimet para dhe pas importit etj).
- (2) Përshkruaj çdo kontrollë mbi importin e kafshëve që kanë qenë të trajtuara me promotorë të rritjes.
- (3) Përshkruaj llojin dhe shpeshësinë e verifikimeve të bëra mbi importimin e kafshëve të gjalla dhe produkteve shtazore në pikën e hyrjes në vend dhe/ose destinacionin e tyre final.
- (4) Trego statusin dhe përgjegjësinë e zyrtarit përgjegjës për kontrollat e importit në pikat e inspektimit kufitar.
- (5) Përshkruaj veprimin në dispozicion nën legjislacion, dhe që me të vërtetë ndërmirret, kur ndonjë import ilegal detektohet.
- (6) Jepni detajet e çdo udhëzimi që u është dhënë zyrtarëve, dhe rezultatin e verifikimeve të ndërmarra.

(7) Përshkruaj procedurat për kontrollat e ndërmarra mbi kafshët dhe produktet shtazore që janë:

– duke hyrë në vend

– duke kaluar nëpër vend

#### **11. FUNKSIONET LABORATORIKE**

(1) Çfarë procedurash ekzistojnë për akreditimin zyrtar të laboratoreve?

(2) Jepni detajet e burimeve financiare në dispozicion për rrjetin e laboratoreve zyrtare.

(3) Jepni detajet për llojin e testeve të ndërmarra nga laboratorët në lidhje me diagnozën dhe monitorimin rutinor të sëmundjeve A të listës së vjetër të OiE.

(4) A është dorëzuar virusi i gjallë në lidhje me listën e vjetër të OiE-së për sëmundjet A? Nëse po, çfarë përkujdesjesh janë vendosur për t'iu shmangur ikjes aksidentale?

(5) Jepni detajet e çdo testi rrethor të organizuar dhe kryer brenda rrjetit laboratorik, dhe/ose me laboratorët në vendet e tjera ose laboratorët referenciale ndërkombëtare. Cilat procedura janë të vendosura në rast të rezultateve të pakënaqshme nga këto teste?

(6) Jepni detajet e sistemeve interne të menaxhimit të cilësisë, psh. Praktikën e Mira Laboratorike, ISO etj. Që ekzistojnë në, ose planifikohen për, sistemin laboratorik.

(7) Çfarë procedurash laboratorike për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe zëvendësimin e reagentëve janë të vendosura?

(8) Përshkruaj kualifikimet e, dhe programet e trajnimit për, personelit të laboratorit.

#### **12. ZOOZOZAT DHE KONTROLLAT E HELMIMIT ME USHQIM**

(1) Përshkruaj çdo program të monitorimit dhe/ose kontrollit në funksion për zoonozat dhe organizmat që helmojnë ushqimin.

(2) Jepni detajet e legjislacionit nacional që mbulon:

– obligimin për të lajmëruar epidemitë e dyshuara/konfirmuara

– veprimet që kërkohen nga fermerët, veterinarët privat, etj.

– veprimet e kërkuara nga shërbimet zyrtare

(3) Jepni rezultatet e sistemit të regjistrimit për epidemitë e zoonozave dhe helmimit të ushqimit në 3 vitet e fundit.

(4) Përshkruaj çdo sistem të vendosur për identifikim dhe lajmërim të shpejtë të epidemive të zoonozës dhe helmimit me ushqim.

(5) Jepni detajet e çdo plani të dokumentuar të ngarkesës, dhe procedurat e vendosura, për hetimin dhe kontrollin e epidemive të zoonozave dhe helmimit me ushqim ndër popullatën e kafshëve dhe njerëzve.

(6) Jepni detajet e kampanjave rutinore dhe të emergjencës për vetëdijësimin e konsumatorëve.

### **13. STANDARDET E SIGURISË SË USHQIMIT (NË RAPORT ME SEKTORËT PËR TË CILËT MIRATIMI KËRKOHET, NËSE ËSHËT E ZBATUESHME)**

*NB. Pyetjet në vijim duhet të përgjigjen në raport me sektor(ët) për të cilat miratimi për të eksportuar në BE është kërkuar (nëse është e zbatueshme).*

#### **13.1. Detajet e prodhimit**

Informatat në vijim për çdo ndërmarje individuale të përpunimit të ushqimit e cila do të propozohet për miratim për treg të BE-së duhet të ofrohen.

- numei i miratimit
- emri i tregtisë
- adresa e plotë
- emri i veterinarit zyrtar përgjegjës për ndërmarje
- lloji dhe vëllimi i të gjitha produkteve nga ndërmarrja
- lloji dhe vëllimi i produkteve të synuara për eksport te BE-ja
- konfirmimi nga shërbimi zyrtar i përmbushjes së standardeve të BE-së

#### **13.2. Të gjitha hapësirat e përpunimit të ushqimit**

(1) Çfarë legjislacioni nacional është i vendosur që do të sigurojë standarde ekuivalente me ato të parashtruara në legjislacionin e BE-së?

(2) Jepni detajet e programeve zyrtare të kointrollit, duke përfshirë sistemet interne të auditit për shërbimet zyrtare, në sektorin e sigurisë së ushqimit. Posaqërisht, informatat mbi sistemet për prioritizim dhe dokumentim të këtyre programeve, dhe rezultatet e tyre, duhet të sigurohen.

(3) Tregoni frekuencën dhe natyrën e kontrollave zyrtare mbi funksionimin e ndërmarjeve të përpunimit.

- (4) Përshkruani procedurat e dhurimit, pezullimit dhe tërheqjes së miratimit për ndërmarjet e procesimit dhe magazinimit.
- (5) Tregoni procedurat e monitorimit të planifikimit dhe kushteve strukturore të ndërmarrjeve.
- (6) Përshkruani kontrollat për përdorimin e shenjave të shëndetit.
- (7) Përshkruani kontrollat për përdorimin e qertifikatave të shëndetit.
- (8) Çfarë aranzhmanesh janë vendosur për provizionin e qertifikatave të barnave për përpunuesit e ushqimit?
- (9) Përshkruani natyrën, frekuencën dhe shtrirjen e kontrollave zyrtare brenda ndërmarrjeve.
- (10) Jepni detajet e procedurave të vendosura për të siguruar gjurmueshmërinë (mbrapa deri te niveli i farmës) të produkteve shtazoretë synuara për konsum të njerëzve.
- (11) Trego kërkesat ligjore për cilësinë dhe sigurinë e ujit.
- (12) Jepni detajet e çdo sistemi "vet-verifikues" (përfshirë HACCP) që operuesit dhe procesuesit kërkohet të zbatojnë. Kjo duhet përfshirë rolin e shërbimit zyrtar në zhvillimin dhe verifikimin e këtyre sistemeve.
- (13) Siguro kopjet e çdo udhëzuesi dhe/ose udhëzimi zyrtar mbi:
- programet e testimit të ujit
  - pastrimin dhe dezinfektimin e ndërmarjeve
  - programet për kontrollin e brejtësve
- (14) Çfarë aksesit kanë shërbimet zyrtare te regjistrat e prodhimit?
- (15) Çfarë veprimi kërkohet të bëjnë operuesit dhe procesuesit nëse një kërcënim serioz për shëndetin e kafshëve ose konsumatorit është identifikuar? Cili është roli i shërbimeve zyrtare në rastet e tilla?
- (16) Çfarë sistemesh janë të vendosura për t'u ofruar trajnim operuesve të kompanisë?
- (17) Cilat janë kualifikimet, trajnimet dhe roli i ndihmësve zyrtar në ndërmarjet e procesimit? Trego çdo restriksion të aktiviteteve të tyre.
- Trego nëse ndihmësit paguhën nga procesuesi apo shërbimet zyrtare.

### **13.3. Prodhimi i mishit të kuq, kafshëve të egra të fermave dhe mishit të lepurit** **Red meat, farmed game and rabbit meat production**

(1) Çfarë legjislacioni është i vendosur për sigurimin e standardeve ekvivalente me ato të parashruara në legjislacionin e BE-së?

**47**

(2) Jepni detajet e çdo programi zyrtar të verifikimeve në-ferma të furnizuesve nëpër ndërmarrje që eksportojnë në BE.

(3) Përshkruaj funksionin e çdo verifikimi dhe kontrolli të shëndetit të kafshëve të ndërmarrë në thertore.

(4) Jepni detajet e inspektimit ante dhe post mortem të ndërmara nga shërbimet zyrtare , dhe të çdo regjistri të rezultateve të këtyre inspektimeve.

(5) Përshkruaj procedurat për identifikim, izolim dhe hedhje të materialit të mohuar dhe të papërshtatshëm.

(6) Jepni detajet e masave të vendosura për të mbrojtur mirëqenien e kafshëve në thertore.

(7) Përshkruaj kontrollat zyrtare të vendosura mbi standardet e higjienës në funksion në ndërmarrjen e procesimit.

(8) jepni detajet e procedurave për shenjime shëndetësore dhe qertifikim të mishit të kuq të karaksëve dhe hedhurinave.

(9) Çfarë verifikimesh janë ndërmarrë për të monitoruar kontrollat e temperaturës së dhomave të magazinimit dhe të punës, dhe të mishit gjatë magazinimit dhe përpunimit?

(10) Aty ku është e përshtatshme (derrat, “thitë e egër” të fermave dhe mishi i kuajve), jepni detajet e verifikimeve zyrtare, ose kontrollave të temperaturës, të ndërmara në raport me rrezikun e kanosur nga tricinelloza në mishin e freskët, përfshirë metodat e testimit të autorizuara për përdorim.

(11) Çfarë kontrollera zyrtare ekzistojnë për therrje dhe procesim të kafshëve të lënduara ose të sëmuara për konsum të njerëzve?

(12) Çfarë procedurash do të vendosen për të siguruar ndarje adekuata e mishit të përshtatshëm të BE-së dhe papërshtatshëm të BE-së?

### **13.4. Mishi i kafshëve të gjahut**

- (1) Çfarë legjislacioni nacional është i vendosur për të siguruar standarde ekvivalente me ato të parashtruara në legjislacionin e BE-së?
- (2) Jepni definicionin ligjor për kafshët e egra të gjahut dhe mishit të nxjerrë prej tyre
- (3) A ekzistojnë heqjet të cilat përjashtojnë klasat e caktuara të gjahut të egër, apo ndërmarje të caktuara të procesimit, psh., vëllimit të vogël prodhues, nga kërkesat legjislative?
- (4) Përshkruani kontrollat mbi gjuajtjen e gjahut të egër, përfshirë çdo ndalesë ndaj atyre që lejohet të gjuhen
- (5) Jepni detajet e kërkesave strukturore dhe të pajisjeve për qendrat e grumbullimit të gjahut dhe ndërmarjeve të procesimit
- (6) Jeoni detajet e kërkesave të inspektimit post mortem, përfshirë përdorimin dhe prezentimin e hedhurinave
- (7) Jepni detajet e çdo detyrimi të kohës dhe temperaturës mbi transferin e gjahut të egër nga pika e gjuajtjes te qendra e grumbullimit, dhe nga qendra e grumbullimit te ndërmarrja e procesimit.
- (8) Çfarë kontrollash të temperaturës janë të zbatueshme për gjahun e egër gjatë transportimit, magazinimit dhe procesimit?
- (9) Çfarë rregullash të higjienës zbatohen në transportin, magazinimin dhe procesimin e gjahut të egër?
- (10) Çfarë rregullash zbatohen për përdorimin dhe aplikimin e shenjave të shëndetit? A ekzistojnë ndalesa mbi atë se kush është i lejuar të aplikojë shenjat e shëndetit?
- (11) Përshkruaj shenjat e shëndetit që përdoren në gjahun e egër, dhe si dallojnë ato nga ato që përdoren në gjahun e farmave.
- (12) Çfarë rregullash zbatohen për hedhjen e materialit të ndaluar dhe të shpallur të papërdorshëm?
- (13) Çfarë rregullash zbatohen për të siguruar identifikim të ndarë të gjahut të egër dhe të fermave?
- (14) Përshkruani procedurat për testim të trichinellas, përfshirë:
  - llojet e testuara
  - mbikqyrjen e procedurave të testimit



- metodat e përdorura të testimit (tregoni nëse ato plotësojnë standardet e BE-së ose ato të posaçme ndërkombëtare), përfshirë reagentët, regjistrimin e rezultateve etj
- kush lejohet të bëjë testet
- minimumi i pajisjeve që kërkohen
- shenjimi i karkaseve që japin rezultatet negative
- veprimet e ndërmarra me karkaset që japin rezultate pozitive

### 13.5. Prodhimet e mishit

(15) Çfarë legjislacioni nacional është i vendosur që do të sigurojë standarde ekvivalente me ato të parashtruara në legjislacionin e BE-së?

(16) Trego nëse ndonjë heqje nga kërkesat ligjore janë dhënë për klasat e caktuara të procesuesve, psh. Vëllimit të vogël prodhues, artizejtarëve etj

(17) Çfarë rregullash ekzistojnë për të siguruar se do të përdoren vetëm materialet e papërpunuara me status të BE-së?

(18) Çfarë kontrollash të temperaturës zbatohen për materialet e papërpunuara dhe produktet e ndjeshme në temperaturë?

(19) Çfarë masash janë vendosur për të siguruar gjurmueshmërinë e produkteve të mishit mbrapa tek hapësirat e origjinës së materialeve të papërpunuara?

49

(20) Çfarë rregullash zbatohen për regjistrimin e kushteve të trajtimit dhe magazinimit?

(21) Çfarë verifikimesh mikrobiologjike kërkohen për produktet e përfunduara?

	<b>Gjedhët</b>				
	Numri total i pronave	Numri total i gjedhëve të rritura të qumështit	Numri total i gjedhëve të rritur që ushqejnë të vegjëlit	Numri total i gjedhëve të rritur për majmëri	Numri total i gjedhëve të therrur
<b>Viti</b>					
<b>Viti</b>					
<b>Viti</b>					

	<b>Derrat</b>			
	Numri total i pronave	Numri total i derrave për shumëzim	Numri total i derrave për majmëri	Numri total i derrave të therrur
<b>Viti</b>				
<b>Viti</b>				
<b>Viti</b>				

	<b>Delet/dhitë</b>				
	Numri total i pronave	Numri total i deleve/dhive qumështore	Numri total i deleve/dhive për shumim	Numri total i deleve/dhive për majmëri	Numri i deleve/dhive të therrura
<b>Viti</b>					
<b>Viti</b>					
<b>Viti</b>					

<b>Kafshët e Gjahun nga ferma</b>					
	Numri total i pronave	Numri total i gjahun të farmave	Numri total i drerëve në farma	Numri total i “derrit të egër në farma”	Numri total i kafshëve të gjahun të farmave të therrura ( trego llojet)
<b>Viti</b>					
<b>Viti</b>					
<b>Viti</b>					

<b>Gjahu i egër</b>				
	Numri total i drerëve të egër	Numri total i derrave të egër	Numri total i gjahun tjetër të egër (specifiko)	Numri i gjahun të egër të gjuajtur (trego llojet)
<b>Viti</b>				
<b>Viti</b>				
<b>Viti</b>				